

Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.

Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore në UK drejtohet nga dekani i fakultetit dhe ka këto funksione:

a) zgjedh rektorin e UK-sw;

b) zgjedh anëtarët e Senatit Akademik të UK-sw;

c) zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore në UK;

ç) krijon dhe zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore.

d) merr në analizë aktivitetin e fakultetit dhe të autoriteteve të tij;

dh) diskuton për problematika të ndryshme që lidhen me fakultetin, mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.

Asambleja e personelit akademik të njësisë bazë zgjedh drejtuesin e njësisë bazë.

Mënyra e funksionimit të Asamblesë së personelit akademik përcaktohet në rregulloren e njësisë kryesore.